

VENDIM
Nr. 606, datë 14.9.2022

PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”
(Ndryshuar me VKM nr. 813, datë 12.12.2022; nr. 267, datë 10.4.2026)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar; të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zbatimin e programit “pas shkolle”, i cili është i organizuar dhe i strukturuar në veprimtari, që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar dhe ka për qëllim përfundimin e të nxënësve dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të aftësive edukative, sociale, sportive, kulturore dhe krijuese të nxënësve, i miratuar sipas ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Programi “pas shkolle” realizohet në institucionet arsimore parauniversitare publike të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë.

3. Plani i veprimit, kriteret për përzgjedhjen e institucioneve arsimore, të mësuesve e trajnerëve për programe specifike të programit “pas shkolle” miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Shfuqizuar.

5. Pagesa për një orë mësimore për zbatimin e programit “pas shkolle” për mësuesit dhe trajnerët, për veprimtaritë që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar, është 1 000 (një mijë) lekë.

6. Shfuqizuar.

6/1. Shfuqizuar.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 1
PROGRAMI KOMBËTAR PËR AKTIVITETET JASHTË ORARIT MËSIMOR
(Shfuqizuar ANEKSI me VKM nr. 267, datë 10.4.2026)